



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË**

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më _____._____.2026

PROJEKT-VENDIM

Datë _____._____. 2026

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN DHE KUSHTET QË
AGJENCITË E SHËRBIMIT FUNERAL DUHET TË PLOTËSOJNË PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË SHËRBIMIT FUNERAL DHE/OSE OFRIMIN PËR SHTËPI
FUNERALE, NË LIDHJE ME KAPACITETET TEKNIKE DHE BURIMET NJERËZORE
NË TERRITORIN E BASHKISË KAVAJË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, i ndryshuar; të Ligjit Nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullore për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar, të VKM-së Nr.408/2015 “Për miratimin e rregullores dhe zhvillimit të territorit” të ndryshuar, të VKM-së Nr.1096/2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike” me miratimin e Kryetarit të Bashkisë, i propozojnë Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të rradhës,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe /ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore, në territorin e Bashkisë Kavajë, sipas dokumentit bashkëngjitur.

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN DHE KUSHTET QË AGJENCITË E SHËRBIMIT FUNERAL
DUHET TË PLOTËSOJNË PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË SHËRBIMIT
FUNERAL DHE/OSE OFRIMIN PËR SHTËPI FUNERALE, NË LIDHJE ME
KAPACITETET TEKNIKE DHE BURIMET NJERËZORE NË TERRITORIN E
BASHKISË KAVAJË

Baza Ligjore

- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.
- Ligji nr.9220, datë 15.04.2004 "Per administrimin e sherbimit të varrimit" i ndryshuar.
- Ligjit nr.10 081, date 23.02.2009 "Per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar.
- Vendimi nr.711, date 29.10.2014 "Per miratimin e rregullores "Per administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqiperise".
- Vendimi nr.712 date 29.10.2014 "Per miratimin e rregullores teknike "Per projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqiperise".
- Vendimi nr. 402, date 05.07.2023 "Per disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.711, date 29.10.2014 "Per miratimin e rregullores "Per administrimin dhe funksionimin e varrezave ne territorin e Republikës së Shqiperisë".

KREUI

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka per objekt percaktimin e kriterëve dhe kushteve plotësuese që agjencitë e sherbimit funeral/shtepite funerale duhet te plotësojne per ushtrimin e aktivitetit të sherbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit per shtepi funerale, ne lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerezore.

Neni 2

Qellimi

Kjo rregullore ka per qëllim percaktimin e struktures pergjegjese, procedurave, kriterëve për licencimin e agjencive te sherbimit funeral për ushtrimin e aktivitetit te shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit per shtepi funerale. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, eshte i detyrueshem per çdo subjekt, që kerkon te ushtroje veprimtari në fushën e varrimit.

Neni 3

Perkufizime

- a. "Shtëpi funerale" eshte ambienti që shërben si shtepi pritjeje, në te cilen veprimtaria per kryerjen e ritualeve te lamtumirës dhe riteve te tjera në nderim te personave te vdekur eshte e padukshme nga jashte.
- b. "Agjenci Funerale" ofron sherbime mbeshtetëse të procesit te varrimit, permes zyrave per informimin e qytetarëve, me qëllim shitjen e artikujve të varrimit dhe vënien ne dispozicion te transportit funeral në perputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.
- c. "Sherbimi funeral" është veprimtaria qe zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës.

Subjekt", sipas kuptimit të kësaj rregulloreje janë personat fizik dhe juridik privat. Person fizik, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm, sipas parashikimeve të nenit 2, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe regjistrohet si i tillë pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit. Person juridik publik ose privat janë shoqëritë tregtare si shoqëritë kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuara dhe aksionare, të cilat kanë personalitet juridik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, si dhe regjistrohen gjithashtu sipas ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar.

dh. "Licencë" është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtroje llojin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

Neni 4

Kufizime

1. Agjencitë e Shërbimit Funeral dhe Shtëpive funerale nuk lejohet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në njësi banimi.
2. Shtëpive funerale duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre në godina të dedikuara me funksion shërbimi.
3. Agjencitë e Shërbimit Funeral dhe Shtëpive funerale duhet të ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm në ambiente të brendshme dhe jo të dukshme nga jashtë.
4. **Njësia bazë e qeverisjes vendore përcakton zonat e qytetit për qëndrimin e makinave funerale dhe zyrat e shërbimit, të cilat nuk duhet të jenë në godina banimi dhe në vende të dukshme për publikun.**
5. Aplikimi për licensimin Agjencive të Shërbimit Funeral dhe Shtëpive funerale kryhet me kërkesë të vete subjekteve pranë Bashkisë Kavajë.

KREU II

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM PËR T'U PAJISUR ME LICENCE

Neni 5

Dokumentacionet e kërkuara për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral

1. Për t'u pajisur me licencë subjekti i pajisur me NIPT për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dorëzon fizikisht pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, në Bashkinë Kavajë, këto dokumente:
 - a) Kërkesën për licencë;
 - b) Vetëdeklarim "Për verifikimin e gjendjes gjyqësore" të administratorit të personit juridik, vertetim nga gjykata që shoqëria nuk është në proces gjyqësor/ nuk është denuar dhe nga prokuroria që shoqëria nuk është në procedim penal;
 - c) Vertetim që janë paguar të gjitha detyrimet tatimore kundrejt Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
 - ç) Ekstrakt historik i subjektit, ku të kete të përcaktuar si objekt të saj zhvillimin e veprimtarive në fushën e shërbimit funeral;
 - d) NIPT-in e subjektit;
 - e) Vertetim/çdo dokument të lëshuar nga Inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë, i cili të vertetojë plotësimin e kushteve për mjetet që merren me transportin e kufomave, sipas pikës 1, të nenit 39, të Vendimit nr. 711, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e depozituar.

g) Listën e personelit të nevojshëm për të zbatuar objektin e veprimtarisë (përfshirë këtu, por pa u kufizuar: infermier, sanitar, shofer, financiar etj.). Lista e personelit duhet të përfshijë funksionin e tyre si dhe licencat profesionale apo çdo dokument tjetër sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

h) Listën e mjeteve e pajisjeve teknike të nevojshme që ka në dispozicion subjekti për përmbushjen e objektit të veprimtarisë (përfshirë këtu, por pa u kufizuar makina autofunebër, kapak frigoriferik, frigorifer të posaçëm për mbajtjen e kufomave etj.);

i) Dokumentacion që vërteton se zotërojnë kapacitet ekonomik e financiar për zhvillimin e aktivitetit dhe anë të balanceve financiare, paraqitjen e një pasqyre financiare që pasqyron fuqinë ekonomike dhe/apo çdo dokument provues nga subjekti, nëse ka.

2. Dokumentacioni i depozituar nga subjektet e interesuara përcillet për vlerësim Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, e cila nëse vëren mungesë dokumentacioni apo pasaktësi, njofton menjëherë subjektin dhe i lë një afat prej 10 ditësh pune për plotësim.

3. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit, subjektit do ti refuzohet licensimi. Subjektit nuk i humbet e drejta për të aplikuar sërish.

4. Dokumentacioni duhet të jetë i lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e dorëzimit të kërkesës për licensim dhe duhet të jetë origjinal ose kopje të noterizuara.

Neni 6

Kushtet për agjencitë funerale

Agjencitë funerale duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) Duhet të sigurojnë të paktën një makinë autofunebër, e cila duhet të jetë sipas specifikimeve teknike të vendosura nga inspektorati i shëndetësisë;

b) Të kenë garazh/parkim të përshtatshëm në varësi të numrit të makinave autofunebër që disponojnë, për të bërë të mundur mos ekspozimin e këtyre mjeteve. Minimalisht hapësira e përshtatshme për një makinë duhet të jetë deri në 15m².

c) Burime njerëzore të mjaftueshme për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral, për Agjencitë Funerale minimalisht 3 (tre) punonjës

Neni 7

Kushtet për shtëpite funerale

Shtëpite funerale duhet t'i përmbahen kushteve teknike të mëposhtme:

a) Burime njerëzore të mjaftueshme për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral, për shtëpite funerale minimalisht 4 (katër) punonjës të punësuar me kohë të plotë, si dhe minimalisht 2 (dy) punonjës të punësuar me kohë të pjesshme ose kontrate shërbimi.

b) Të kenë salla ceremoniale (ambient pritjeje) të përshtatshme, për të kryer ritet fetare të lamtumirës së fundit, nga të gjitha komunitetet fetare.

c) Një dhomë të posaçme sanitare, për shërbime pastrimi e veshje kufome, duke garantuar higjienën dhe sigurinë publike, si edhe respektimin e rregullave për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punemarresve. Kjo dhomë duhet të jetë e pajisur me një dyshemë sanitare dhe kullimin e nevojshëm, ventilim, tavolina të miratuara të nevojshme, uje të rrjedhshëm të nxehtë dhe të ftohtë, lavaman të ndare nga kullimi i tavolines si dhe të gjitha instrumentat e nevojshme për trajtimin dhe përgatitjen e trupave të vdekur.

d) Dhomë të posaçme (morg), me qëllim vendosjen e kufomave, para se të kryhet ceremonia e lamtumirës, në sallën ceremoniale. Temperatura brenda në këtë dhomë duhet të mbahet konstante ndërmjet vlerave 2°-12°C. Kjo temperatura konstante duhet të mbahet nepermjet një njesie qendrore, që duhet të sigurojë edhe ventilim të vazhdueshëm. Dyshemeja duhet të jetë e papershkueshme nga lengjet dhe e lemuar, në mënyrë që të pastrohet lehtë.

e) Dhoma higjieno sanitare të posaçme për personelin, me sipërfaqe minimum 12 m².



do ndertese te projektohet e tille që te plotesoje kushtet e perdorimit bazuar ne Vendimin e shillit te Ministrave nr.1503, date 19.11.2008 "Per shfrytezimin e hapësirave nga ana e personave ne aftesi te kufizuar".

PROCEDURAT PËR VERIFIKIMIN DHE SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT

KREU III

Neni 8

Verifikimi dhe shqyrtimi

1. Verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentave per licencim behet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, ne Bashkine Kavajë.
2. Struktura e percaktuar ne pikën 1, te ketij Kreu, e ngarkuar me detyrën verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të percaktuar në Kreun II, të kësaj regulloreje, verifikon dokumentacionin e depozituar nga subjekti aplikues, e cila nëse veren mungese dokumentacioni apo pasaktësi, njofton menjëhere subjektin e interesuar dhe i le nje afat prej 10 ditesh pune per plotesim.
3. Në rast te mosplotësimit sipas pikës 2, subjektit do t'i refuzohet licencimi. Subjektit nuk i humbet e drejta per të aplikuar sërish.
4. Dokumentacioni duhet të jete i lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e dorëzimit te kërkeses per licencim dhe duhet te jete origjinal ose kopje të noterizuara.
5. Nese dokumentacioni eshte i plote, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, brenda 5 ditëve pune, pasi njoftohet mbi aplikuesin/aplikuesit që kanë depozituar dokumentacionin e plote, percakton një date per inspektimin ne vend, ne lidhje me objektin, kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore, si garanci e vazhdimësisë dhe pershtatshmërisë të shërbimit, garancisë se sipërmarrjes, respektimit te regullave te sigurise dhe te shendetit te punëmarresve dhe respektimit te legjislacionit në lidhje me realizimin e shërbimeve funerale, dhe ia njofton ate menjëherë subjektit aplikues. Në çdo rast data e percaktuar për inspektimin ne vend nuk mund te jetë më parë se 5 (pesë) dite nga momenti i njoftimit.

KREUV

PROCEDURA E MIRATIMIT, REFUZIMIT DHE RIPERTERITJES SË LICENCES

Neni 9

Inspektimi paraprak

Inspektimi në terren konsiston në verifikimin në vend te kushteve teknike ne varesi te shërbimit që ofrojne agjencite dhe/ose shtepite funerale dhe realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, duke ju referuar kesaj rregulloreje.

Neni 10

Procedura e miratimit

1. Pasi struktura pergjegjese ka inspektuar ne vend ambientin dhe ka konkluduar ne plotesimin e kushteve, kryetari i Bashkise miraton kërkesën për pajisje me licencë.
2. Në rastet kur kjo strukturë ka konstatuar mosplotesim/mosrespektim te kushteve teknike, i le një afat kohor prej 30 ditesh subjektit me qëllim plotësimin e mangësive te konstatuara. Nese subjekti ne perfundim te ketij afati nuk merr masat e nevojshme, komisioni harton raportin përmbledhes dhe vë në dijeni kryetarin e Bashkise, duke i propozuar refuzimin e licences.



Neni 11 Vendimmarrja

1. Vendimi i miratimit/refuzimit nga kryetari bazohet në dokumentet provuese të licencimit, si dhe në inspektimin në vend e vleresimit faktik të plotësimit të kriterëve përkatës të licencimit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit.

2. Kryetari, vendos për:

- a. miratimin e kërkesës për pajisje me licence;
- b. refuzimin e kërkesës për pajisje me licence. Në këtë rast, arsyetimi ligjor përkatës, në të cilin përcaktohen qartë shkaqet e refuzimit, i behen me dije subjektit aplikues. Nëse subjekti nuk është dakord me vendimin e marrë për refuzimin e kërkesës për licencim, ai ka të drejtën e ndjekjes së procedurës së ankimimit.

3. Vendimmarrja e kryetarit i njoftohet aplikuesit nëpërmjet shërbimit postar dhe/ose adresës elektronike. Subjekti pasi njihet me vendimmarrjen për miratimin e kërkesës për licencim, paraqitet në Bashkinë e Kavajës për të tërhequr licencën.

Neni 12 Forma dhe vlefshmëria e licences

1. Format i licences do të jetë sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë perberëse e kësaj rregulloreje.
2. Licenca hyn në fuqi menjëherë dhe afati i vlefshmërisë është 5 (pesë) vjet me të drejtë rinovimi. Me mbarimin e afatit të vlefshmërisë së saj, subjekti i lind e drejta të pajiset me licence të re, duke dorëzuar dokumentacionin e përcaktuar në këtë rregullore. Kërkesa për ripërteritje të licences bëhet 60 (gjashtëdhjetë) ditë para përfundimit të afatit të licences që ka në përdorim personi juridik/personi fizik.
3. Mosparaqitja e kërkesës për ripërteritjen e licences brenda afatit 60-ditor para përfundimit të afatit të licences që ka në përdorim subjekti, sjell pezullimin e aktivitetit të subjektit.
4. Licenca është personale për subjektin dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër juridik apo fizik.

KREU VI PEZULLIMI DHE HEQJA E LICENCES

Neni 13 Kontrolli periodik

1. Subjektet e licencuara sipas kësaj rregulloreje, i nënshtrohen një kontrolli periodik të paktën 2 (dy) herë në vit, i cili kryhet nga specialistet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, sipas planit të punës së miratuar nga drejtori.
2. Kontrolli periodik bëhet mbi verifikimin dhe ruajtjen e kriterëve të licencimit si dhe për dokumentimin e të dhenave të/për aktivitetin nga subjekti i licencuar në përputhje me përcaktimet kuadrit rregullator në fuqi.
3. Në rast se gjatë kontrollit periodik, konstatohet mosrespektimi i kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e aktivitetit, mbahet procesverbali përkatës, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit apo një person i autorizuar prej tij dhe grupi i inspektimit.
4. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjelbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit i propozon kryetarit të bashkisë, pezullimin e licences.

Sanksionet administrative dhe menyrat e caktimit të tyre

Neni 14

- Sanksionet/Aktet administrative per kundervajtjet e parashikuara në këte rregullore, jane:
- Paralajmërim me shkrim/Akt konstatimi,
 - Procesverbal per kundervajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobes,
 - Pezullimin e licences dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit sipas afatit të pezullimit,
 - Heqjen e licences dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit.
2. Sanksioni "Paralajmërim me shkrim" është akt administrativ, që ka për qëllim keshillimin, paralajmërimin dhe lenien e detyres per kundervajtjesit.
3. Në rast perseritje të kryerjes të se njejtës kundervajtje apo të një kundervajtje administrative tjeter sipas kësaj rregulloreje apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobe.
4. Në rast vijimi të kryerjes së kundervajtjes/kundervajtjeve duke mosrespektuar kushtet dhe kriteret e percaktuara sipas kësaj rregulloreje apo legjislacionit në fuqi pas aplikimit të masës administrative me gjobe, ndaj subjektit vijojnë masat në rend hierarkik:
- Pezullimin e licences dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit sipas afatit të pezullimit.
 - Heqjen e licences dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 15

Pezullimi dhe heqja e licenses

- Pezullimi i licences ndaj subjektit bëhet me vendim të kryetarit të Bashkise, pas shqyrtimit të shkeljeve të konstatuara.
- Urdheri për pezullimin i bëhet me dije subjektit, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, duke i lene nje afat 30 ditor për ndreqjen e shkeljes se konstatuar.
- Urdheri i pezullimit shfugizohet nga kryetari i bashkisë, sipas legjislacionit në fuqi, kur vleresohet se subjekti i ka plotësuar të gjitha shkeljet e konstatuara, sipas rastit.
- Në rast se shkelja e konstatuar nuk korrigjohet nga subjekti brenda afatit të percaktuar në urdherin e pezullimit, struktura pergjegjese, i propozon kryetarit të Bashkise marrjen e vendimit mbi heqjen e licences.
- Heqja e licences behet në keto raste:
 - kur rrethanat janë të tilla, që s'do të kishte kuptim apo mundesi per ripërmbyshjen e kriterëve apo ndregjen e shkeljes se detyrimeve nga subjekti, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;
 - në rast të moszbatimit të urdherimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
 - në rastin e shkeljeve të renda me faj nga subjekti dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar demtim të interesit publik, qe garantohet nga titulli perkates apo legjislacioni në fuqi.
- Vendimi i Kryetarit të Bashkise per heqjen e licences, përmban shkeljen e konstatuar dhe i njoftohet subjektit, sipas rregullave të percaktuara në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative". Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, në bashkëpunim me Policine Bashkiake merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e ketij vendimi.
- Subjekti ka të drejten e ankimit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

**KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 16

Afatet dhe Detyrimet

- Per subjektet të cilët janë regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit, me object ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, përpara hyrjes në fuqi të kesaj rregulloreje, detyrohen qe brenda 6 (gjashte) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të

SHQIP
[Stamp]

mbushin kushtet dhe te plotqsojne dokumentacionin sipas kërkesave te këtij akti dhe t'i dorëzojne fizikisht pranë Bashkise Kavajë.

2. Në rast te mos plotesimit te kushteve per licencim brenda këtij afati, këto subjekte nuk mund te ushtrojne aktivitetin. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, në bashkëpunim me Policine Bashkiake, në rast se gjatë kontrollit periodik konstaton mos plotesimin e tyre, merr te gjitha masat e nevojshme per mos lejimin e ushtrimit te këtij aktiviteti, në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e percaktuara në kete rregullore.

3. Per subjektet te cilat pajisen per here te pare me NIPT, me objekt veprimtarie në fushen e sherbimeve funerale, duhet qe brenda dy muajve nga regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit, të ndjekin proceduren sipas parashikimeve te kësaj rregullore, per pajisjen me licence per ushtrimin e aktivitetit si Agjenci Funerale apo Shtëpi Funerale.

Neni 17

Strukturat zbatuese

1. Strukturat e ngarkuara per zbatimin e kësaj rregullore ne lidhje me licencimin e aktivitetit ushtrimit te aktivitetit te sherbimit funeral dhe ofrimin e sherbimit per shtëpi funerale janë:

a) Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit:

- pranon, verifikon dhe regjistron kerkesat dhe dokumentacionin e paragitur nga subjektet aplikante per pajisje ose ripërteritje te licences.
- kryen inspektime ne terren per te verifikuar plotesimin e kushteve teknike, higjieno-sanitare dhe ligjore, si dhe harton raportet perkatese.
- paraqet Kryetarit të Bashkisë memo dhe rekomandime per miratimin, refuzimin, pezullimin ose heqjen e licences.
- kryen inspektime te pakten 2 (dy) herë ne vit per te verifikuar respektimin e kriterëve te licencimit nga subjektet e licencuara.
- regjistron dhe perditeson te dhenat per te gjitha subjektet e licencuara dhe statusin e licencave të tyre.
- i komunikon aplikuesit dhe subjektit vendimet e Kryetarit te Bashkise nepermjet postes dhe/ose adreses elektronike,
- ne bashkepunim me Policine Bashkiake, siguron ekzekutimin e vendimeve të pezullimit ose heqjes se licences.

b) Policia Bashkiake:

- mbështetje gjate inspektimeve, asiston dhe garanton rendin gjate kontrolleve periodike ose verifikimeve te papritura te kryera nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit,
- zbatimi i vendimeve te pezullimit ose heqjes së licences,
- merr masa per nderprerjen e menjehershme te aktivitetit te subjekteve kur kjo eshte urdheruar me vendim te Kryetarit te Bashkisë.
- parandalimi i ushtrimit te aktivitetit pa licence
- kontrollon dhe evidenton subjektet që ushtrojne veprimtarinë ne mënyrë te paligjshme, duke raportuar menjëhere te strukturat perkatese te Bashkise.
- merr masa administrative ose te menjehershme ndaj subjekteve që shkelin rende dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi, sidomos kur preket interesi publik.

ushtrimit kushtet dhe te plotqsojne dokumentacionin sipas kërkesave te këtij akti dhe t'i dorëzojne fizikisht pranë Bashkise Kavajë.

Në rast te mos plotesimit te kushteve per licencim brenda këtij afati, këto subjekte nuk mund te ushtrojne aktivitetin. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit, në bashkëpunim me Policine Bashkiake, në rast se gjatë kontrollit periodik konstaton mos plotesimin e tyre, merr te gjitha masat e nevojshme per mos lejimin e ushtrimit te këtij aktiviteti, në kundërshtim me kriteret dhe kushtet e percaktuara në kete rregullore.

3. Per subjektet te cilat pajisen per here te pare me NIPT, me objekt veprimtarie në fushen e sherbimeve funerale, duhet qe brenda dy muajve nga regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit, të ndjekin proceduren sipas parashikimeve te kësaj rregullore, per pajisjen me licence per ushtrimin e aktivitetit si Agjenci Funerale apo Shtëpi Funerale.

Neni 17

Strukturat zbatuese

1. Strukturat e ngarkuara per zbatimin e kësaj rregullore ne lidhje me licencimin e aktivitetit ushtrimit te aktivitetit te sherbimit funeral dhe ofrimin e sherbimit per shtëpi funerale janë:

a) Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit:

- pranon, verifikon dhe regjistron kerkesat dhe dokumentacionin e paragitur nga subjektet aplikante per pajisje ose ripërteritje te licences.
- kryen inspektive ne terren per te verifikuar plotesimin e kushteve teknike, higjieno-sanitare dhe ligjore, si dhe harton raportet perkatese.
- paraqet Kryetarit të Bashkisë memo dhe rekomandime per miratimin, refuzimin, pezullimin ose heqjen e licences.
- kryen inspektive te pakten 2 (dy) herë ne vit per te verifikuar respektimin e kriterëve te licencimit nga subjektet e licencuara.
- regjistron dhe perditeson te dhenat per te gjitha subjektet e licencuara dhe statusin e licencave të tyre.
- i komunikon aplikuesit dhe subjektit vendimet e Kryetarit te Bashkise nepermjet postes dhe/ose adreses elektronike,
- ne bashkëpunim me Policine Bashkiake, siguron ekzekutimin e vendimeve të pezullimit ose heqjes se licences.

b) Policia Bashkiake:

- mbështetje gjate inspektiveve, asiston dhe garanton rendin gjate kontrolleve periodike ose verifikimeve te papritura te kryera nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Pastrimit, Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, Gjellbërimit dhe Varrezave, Ujitjes dhe Kullimit,
- zbatimi i vendimeve te pezullimit ose heqjes së licences,
- merr masa per nderprerjen e menjehershme te aktivitetit te subjekteve kur kjo eshte urdheruar me vendim te Kryetarit te Bashkisë.
- parandalimi i ushtrimit te aktivitetit pa licence
- kontrollon dhe evidenton subjektet që ushtrojne veprimtarinë ne mënyrë te paligjshme, duke raportuar menjëhere te strukturat perkatese te Bashkise.
- merr masa administrative ose te menjehershme ndaj subjekteve që shkelin rende dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi, sidomos kur preket interesi publik.

per çdo rast shkeljeje të konstatuar, harton procesverbale dhe i percjell ato tek Drejtoria
pergjegjese per marrjen e masave administrative dhe ligore.

SHKËRIM
BASHKIA KAVAJE

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 10 dite pas miratimit në Këshillin e Bashkiak të Bashkise Kavajë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Adrian Malaj

DREJTORIA LIGJORE

Helidon Plaku

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, PASTRIMIT, MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE
RURALE,
GJELBËRIMIT DHE VARREZAVE, UJITJES DHE KULLIMIT

Marjush Kola

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

Albi Lushka

DREJTORIA E TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE,
TË ARDHURA DHE BORXHIT

Jurgen Kariqi

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Dëshira Qato

DREJTORIA E MJEDISIT DHE E PYJEVE

Florian Mërhoni

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Meri Biturku

KRYETARI

FISNIK QOSJA



[Handwritten signatures and notes]